



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuyendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA CRAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. I prot. 178 Mě. 20.01.2020
Br. prot. Dt.
RAHOVEC - ORAHOVAC

**Ministria e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovec/Skopština Opštine Orahovac/Municipal Assembly
Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
Odeljenje za Privreda, Razvoj i Turizam
Department of Economy, Development and Tourism**

DATË /A:	31.12.2019
REFERENC-Ë:	Raporti i punës
PËR/ZA/TO :	Z. Smajl Latifi, Kryetar i komunës
CC:	
NGA/OD/FROM:	Z. Artan Asllani, Drejtor për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm <i>Asllani</i>
LËNDA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport i punës janar - dhjetor 2019

Raporti është i bazuar në planifikimin, objektivat dhe detyrat e punës.

DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm ka për qëllim ngritjen dhe modernizimin e tregut në sektorin privat, shërbimet efikase për të gjitha bizneset e komunës sonë, po ashtu, ofrimin e kushteve në të bërit biznes me një klimë më të përshtatshme për të gjithë bizneset e komunës së Rahovecit.

Fushe veprimtaria e Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm është e bazuar në aktet normative në fuqi dhe në planin e punës për vitin 2019. Në kuadër të drejtorisë së DEZHT-së, nga janari janë realizuar një mori aktivitetesh. Ndër më kryesoret do të paraqiten të specifikuara sipas kohës në të cilën kanë ndodhur të kategorizuara në periudha tremujore.

Tremujori i parë: janar, shkurt, mars

Gjatë kësaj periudhe të vitit 2019 është bërë regjistrimi i të gjitha subjekteve afariste prej librit kryesor të vitit 2018 dhe regjistrimi në librin e ri të vitit 2019, një ashtu gjatë fillimit të vitit 2019 është bërë edhe kalkulimi i ngarkesave për vitin 2019 në formë elektronike, përpilimi dhe analizimi i ngarkesave të taksës afariste komunale për vitin 2019. Në tremujorin e parë të vitit 2019 është bërë shtypja e aktvendimeve për të gjithë bizneset që janë të ngarkuara me taksë afariste komunale ku në bazë të kësaj ne kemi arritur të kemi një rritje të konsiderueshme të të hyrave në taksa afariste komunale.

KOMUNA RAHOVEC

Një e arritur tjetër me rëndësi për DEZHT është se për herë të parë Komuna e Rahovecit nuk ka marrë rekomandim nga ana e auditorit të jashtëm për regjistrimin dhe vlerësimin e aseteve komunale, pasi që ne kemi bërë me kohë regjistrimin dhe vlerësimin e tyre.

Tremujori i dytë: prill, maj, qershor

Gjatë kësaj periudhe raportuese ne kemi vazhduar me mirëmbajtjen e sistemit të pasurisë financiare dhe jo financiare, po ashtu në kuadër të DEZHT-së është formuar komisioni për vlerësimin e tokave të komunës së Rahovecit proces ky i përfunduar me sukses gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2019.

Në bazë të një hulumtimi dhe anketimi që ju është bërë bizneseve në Kosovë nga INDEKSI I KONKURUESHMËRISË SË KOMUNAVE, Rahoveci renditet në vendin e dytë bashkë me Zyrën tonë të Regjistrimit të Bizneseve (ARBK-në), për shërbime të shpejta dhe efikase.

Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator

Ofrimi i mbështetjes për bizneset fillestare dhe atyre ekzistuese të vogla e të mesme, vazhdon të mbetet prioritet i yni me rëndësi, andaj gjatë kësaj periudhe janë vizituar shumë biznese të komunës së Rahovecit për të parë nga afér mbarëvajtjen e procesit të punës, nevojat dhe kërkesat e tyre drejtë realizimit në të bërit biznes dhe mundësinë e të ofruarit ndihmë për zhvillimin e këtyre bizneseve me të gjitha kapacitetet që ne i posedojmë. DEZHT- gjatë muajit korrik ka bërë thirrjen për përkrahjen e bizneseve prodhuese dhe përpunuese të metalit, drurit, plastikës dhe artizanateve ku në bazë të kësaj thirrjeje kanë përfituar gjithsej 12 biznese që veprimtarinë e tyre e ushtrojnë në komunën e Rahovecit.

Në kuadër të Zyrës për Informacione Turistike, është bërë pritja dhe informimi i të gjithë turistëve që kanë frekuentuar komunën tonë gjatë kësaj periudhe, po ashtu janë zhvilluar takime me organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare që lidhen me sektorin e turizmit.

Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor

Periudhën e fundit të vitit 2019 ka vazhduar ta karakterizojë mbikëqyrja dhe inkasimi i të hyrave në qira si dhe në taksa afariste komunale si dhe mbikëqyrja e objekteve afariste komunale, lidhja e kontratave të reja etj.

PROJEKTET E INVESTIMEVE KAPITALE

- Tregu i kombinuar- Kemi përfunduar projektin për riparimin e tregut në Rahovec, projekti është investim i Komunës së Rahovecit me vlerë prej: 3,444 Euro, në të cilin përfshihen: Rrethimi i tregut, ngjyrosja e shtandeve, pastrimi i mjedisit, pastrimi, zhbllokimi dhe riparimi i nyjeve sanitare dhe largimi i mbeturinave përreth;
- Investime në infrastrukturë, në Zonën ekonomike- Më datë 22.06.2018, me vendim të Qeverisë së Kosovës është krijuar Zona Ekonomike me një hapësirë prej 35,84 ha, ka mbetur të bëhet

KOMUNA RAHOVEC

vetëm licencimi i zonës industriale nga ana e MTI-së dhe fillimi i investimeve direkte në zonë, deri më tani është përfunduar rrethimi i një pjese prej 1500m me mur mbrojtës si dhe pastrimi përreth kësaj zone;

- Shtëpia e të moshuarve për qëndrim ditor- Mbi qytetin e Rahovecit, tek "Epopëja e UÇK-së", ka filluar ndërtimi i shtëpisë për të moshuar për qëndrim ditor. Kjo është kërkesë e kahershme e qytetarëve të moshës së shtyer dhe Komuna e Rahovecit do ti jep jetë si investitor me vlerën e kontratës: 89,979.00 euro. Në këtë qendër parashihet të ketë një sallë kolektive për qëndrim dhe aktivitete, dhoma për të pushuar si dhe teracë;
- Shtegu i ecjes" (Maja e Shkodranit) - Projekt rekreativ për ecje deri te Maja e Shkodranit me gjatësi 1.5 kilometra që është finalizuar tashmë nga Komuna e Rahovecit dhe mbështetur nga Ministria e Zhvillimit Rajonal;
- Asfaltimi i rrugës nga Epopëja e UÇK-së deri tek Maja e Shkodranit- ky projekt ka përfunduar me sukses, ka mbetur të bëhet vetëm sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugës;
- Ndërtimi i shtigjeve të ecjes në Komunën e Rahovecit – Ky projekt është duke vazhduar, kemi përfunduar me krijimin e dy shtigjeve të ecjes në fshatin Dejnë si dhe në pikën turistike Zhdrellë, punimet pritet të fillojnë edhe në fshatrat Krushë e Madhe dhe Drenoc;

Zyra për taksa afariste komunale

Tabela e të hyrave për periudhën raportuese janar- dhjetor 2019:

Muajt	Objektivi 2019	Viti 2019
	75.000,00 €	SHUMA
Janar		6.177,00 €
Shkurt		5.525,00 €
Mars		5.765,00 €
Prill		8.682,00 €
Maj		13.425,00 €
Qershor		8.654,00 €
Korrik		5.594,00 €
Gusht		5.234,00 €
Shtator		5.608,00 €
Tetor		8.121,00 €
Nëntor		4.132,00 €
Dhjetor		5.000,00 €
TOTALI:		81.917,00 €

Të hyrat nga qiraja për periudhën janar – dhjetor dhe saldoja është paraqitur në tabelën më poshtë:

60,133.64€

Të hyrat nga saldoja për periudhën janar- dhjetor 2019

40,636.57 €

Zyra e regjistrimit të bizneseve

Për periudhën janar- dhjetor 2019, në Zyrën e Qendrës Komunale për Regjistrimin e Bizneseve (QKRB) janë të regjistruara në protokoll, biznese të reja dhe janë shqyrtuar gjithsej lëndët si në tabelën vijuese:

Biznese të reja	126
Shuarje Biznesi	41
Informatë Biznesi	41
Ndryshim Biznesi	100
Duplikat Çertifikatë	1
Çertifikatë NUI	786
Vërtetime	3
Konfirmime	14
Çertifikatë e Re	6
Numri fiskal	1
Konsultime + Korigjime	1
Gjithsej	1,120

Regjistrimet e pasurisë mbi 1000€	Regjistrimet e pasurisë nën 1000€	Regjistrimi i ngastrave të tokës
211 lëndë	238 lëndë	1069 ngastra të tokave

Me respekt,

KOMUNA RAHOVEC